

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, - Departamenti për Krime të Rënda, kryetarja e trupit – gjyqtarja Ajser Skenderi, gjyqtarët Skender Çoçj dhe Luan Berisha - anëtarët e trupit, me procesmbajtsen Sheqere Braha, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1. të KPK, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr. 234/12-II të datës 30.09.2013, pas mbajes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Sefer Morina, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. E. G. më datën 21.12.2015, muarr dhe publikisht e shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. K., nga i ati N. dhe e ëma Z. e lindur B., data e lindjesi... në Prizren, ka të kryer Fakultetin, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

Konformë nenit 364 par.1. p.1.3. të KPP

LIROHET NGA AKUZA

Se më datën 12.11.2010 në kohë të papërcaktuar në Prizren në cilësinë e personit zyrtar kërkon dhe merrë përfitim material për vehte në mënyrë të kundërligjshme, që të mos e kryejë veprimin e tij zyrtar të cilin ai duhet ta kryejë, në atë mënyrë që si zyrtar në Komunën e Prizrenit, pasi paraprakisht merret vesh që të takohet në vendin e quajtur „Shadervan“ saktësisht afër kishës me L. K., nga ai merrë shumën e të hollave prej 500 Euro në mënyrë që të mos ia ndërpret punimet e ndërtimit të objektit të cilën e kishte filluar në tokën bujqësore që gjendet në anën e djathtë të drejtimit rugor Prizren-Zhur për të cilën i akuzuari si zyrtar ka qenë i autorizuar të mos lejoi ndërtimin në tokë bujqësore pa u pajisur me leje përkatëse të shëndrrimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Këso dore kishte për të kryer veprën penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.1. të KPK.

Shpenzimet procedurale bijnë në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda kësaj gjykate ia ka parashtruar aktakuzën PP.nr.234/12-II të datës 30.09.2013 kundër të akuzuarit A. K. për shkak të veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.I. të KPK. Në fjalën përfundimtare PSH Sefer Morina ka deklaruar se ngelë në tërësi pranë aktakuzës pasiqë gjatë seancave gjyqësore dhe provave të administruara, nga deklarata – dëshmia e të dëmtuarit edhe në cilësinë e dëshmitarit L. K. sikurse në procedurën parapenale, paraprake në prokurori e gjithashtu edhe gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari është kryerës i veprës penale marrja e ryshfetit nga neni 343 par.I. të KP, për çka i ka propozuar gjykatës që të njejtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoi sipas ligjit.

I dëmtuari L. K. ia ka lënë në vlerësim gjykatës.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. E. G. ka ngelë në tërësi pranë fjalës përfundimtare të datës 30.06.2014 duke shtuar se edhe po të ekziston vepra penale marrja e ryshfetit ashtu siq pretendon prokurori këtu mungon koha e saktë për të cilën dispozitat ligjore janë konkrete, vendi dhe personat. Nga provat e administruara, inspektorët të cilët janë marrë në cilësi të dëshmitarëve kanë sqaruar se nuk kanë dijeni dhe as që kanë patur mundësi të shohin një gjë të tillë, poashtu edhe inicuesi i kësaj çështje penale dëshmitari Z. B. u deklarua se as në polici e as këtu – gjatë shqyrtimit nuk e ka përmend A. K., por në polici ka deklaruar si përfaqësues i një subjekti politik që ka denoncuar në përgjithësi udhëheqjen komunale dhe sistemin e jo konkretisht këtu të akuzuarin A. K. Poashtu edhe i dëmtuari në deklaratën e tij të dhënë në polici në faqen 2, ka deklaruar se ka patur me vehte 500 Euro dhe ia ka dhënë më të vjetrit që emrin nuk ia din. Në deklaratën e parë në polici nuk është precizuar me emër dhe mbiemër që ka të bëjë me të mbrojturin e tij. Poashtu, edhe gjatë shqyrtimit ka deklaruar që nuk i kujtohet. Ka propozuar që mungesë të provave i akuzuari të lirohet nga akuza, me çka është pajtuar edhe vet i akuzuari.

Gjatë procedurës së provave është dëgjuar i dëmtuari L. K. i cili ka deklaruar se ngelë në tërësi në deklaratën e dhënë në procesverbalin e shqyrtimit të datës 23.01.2014 duke shtuar se nuk i kujtohet cilin vit ka filluar që ta ndërtoi objektin dhe se në atë objekt kanë qenë shumë inspektor dhe nuk ka qenë në dijeni cili është A. Poashtu, ka shtuar se pasiqë ka kaluar një kohë e gjatë ka harruar a i ka dhënë të holla personit – këtu të akuzuarit, dhe se nuk ka qenë i sigurt se në vendin e ngjarjes a ka qenë konkretisht edhe i akuzuari pasiqë kanë qenë disa persona. Si i dëmtuar nuk ka parashtruar kërkesë pasuroro-juridike.

Dëshmitarja L. S. ka deklaruar se shumicën e rasteve me A. K. kanë dalë bashkë në teren dhe se me A. nuk ka qenë tek objekti i L. K. në afërsi të fshatit V., dhe se nuk ka njohuri se i akuzuari a ka qenë tek objekti i të dëmtuarit L. K.

Dëshmitari A. G. ka deklaruar se gjatë vitit 2010 ka dalë në teren me inspektorin A. K., mirëpo nuk ka qenë në inspektim te L. K. dhe se të njejtin nuk e njeh.

Dëshmitari Z. B. në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 18.12.2015 ka deklaruar se ngelë pranë deklaratës së dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 22.04.2014 ndërsa nuk ngelë pranë deklaratës të cilën e ka dhënë në polici pasiqë deklarata e tij publike nuk është trajtuar ashtu siq e ka thënë. Poashtu, ka deklaruar se nuk është e vërtet që rastin në polici sa i përket të akuzuarit A. K. e ka paraqitur ai dhe se nuk i kujtohet që me ndonjë rast i dëmtuari L. K. i ka thënë që të akuzuarit A. K. i ka dhënë 500 Euro.

Nga procesverbali mbi inspektimin e kryer të datës 12.11.2010 vërtetohet se këtu i akuzuari si inspektor së bashku me E. I. kanë qenë në parcelën bujqësore të investitorit R. Sh. ku i pranishëm ka qenë L. K. dhe se i është urdhëruar që ti ndal punimet derisa të sigurohet pëlqimi nga Drejtoria për urbanizëm dhe se në bazë të procesverbalit të përpiluar është marrë edhe aktvendimi me nr.04/5-321-275 të datës 08.12.2010 për ndërprerjen e punimeve e të cilën e ka nënshkruar këtu i akuzuari A. K.

Nga raporti i “Valës” vërtetohet se i akuzuari A. K. më datën 14.12.2010 në ora 08.42 minuta dhe 12.05 minuta është thirrë me telefon nga i dëmtuari L. K. dhe se njëra bisedë – telefonatë ka zgjatur 25 ndërsa tjetra 35 sekonda, mirëpo, nuk ka të dhëna se çka ka qenë përmbajtja e bisedës, pasi që nuk ka transkript të bisedave.

I akuzuari A. K. në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ngelë në tërësi pranë deklarave të dhëna të mëparëshme si në polici, prokurori dhe në gjykatë, ku në mes tjerash në shqyrtimin e mëparshëm ka deklaruar se më datën 12.11.2010 ka qenë në inspektim në fshatin V. dhe e ka përpiluar procesverbalin mbi ndalimin e punimeve në tokën bujqësore në emër të R. Sh., ku së bashku me të ka qenë edhe E. I. dhe qëllimi ka qenë që ti ndalin punimet. L. K. është paraqitur si njeri prezent – shoku i R. Sh. duke i thënë se punimet kryhen për R. Sh. dhe se procesverali i është dorëzuar L. K. me qëllim që të ia dërgon R. Sh. Nuk i kujtohet se pas inspektimit a ka kontaktuar ndonjëherë me L. K., a e ka thirrë ndonjëherë nëpërmjet telefonit dhe se a është takuar në ndonjë vend jashtë zyrës, dhe se të gjitha janë të pavërteta.

Në bazë të lartëcekurave, pas vlerësimit të provave të nxjerrura, në rastin konkret me asnjë provë Prokurori i shtetit nuk ka mundur që të vërtetoj tezën e akuzës se këtu i akuzuari A. K. ka kryer veprën penale marrja e rryshfetit nga neni 343 par.1. të KPK.

Gjatë ëshqyrtimit gjyqësor 18.12.2015 i dëmtuari L. K. ka deklaruar se në vendin e ngjarjes ku është ndërtuar objekti kanë qenë shumë inspektor dhe se nuk e ka dijtë cili është A, nuk din se të akuzuarit a i ka dhënë të hollat apo jo, në shiqim në vendin e ngjarjes kanë qenë disa persona ndoshta ka qenë edhe i akuzuari por nuk ka qenë i sigurt. Nga ana tjetër dëshmitari Z. B. e ka mohuar faktin se e ka paraqitur rastin në polici konkretisht për të akuzuarin A. K. duke shtuar se deklarata e tij publike nuk është trajtuar ashtu siq e ka thënë dhe se nuk i kujtohet që ndonjëherë i dëmtuari L. K. i ka thënë se këtu të akuzuarit i ka dhënë 500 Euro.

Në rastin konkret nuk ka qenë kontestues fakti se këtu i akuzuari ditën kritike ka qenë në teren së bashku me kolegun e tij E. I. ku me atë rast është përpiluar edhe procesverali mbi ndalimin e punimeve në atë vend, që i është dorëzuar të dëmtuarit L. K. me qëllim që i njejtë të ia dorëzoi R. Sh. si investitor. Pas përpilimit të procesberbalit është marrë edhe aktvendimi i lartëcekur mbi ndërprerjen e punimeve.

Mirëpo, kontestues ka qenë fakti se këtu i akuzuari a ka pranuar të holla në shumën prje 500 Euro nga i dëmtuari L. K. apo jo. Në këtë drejtim Prokurori i Shtetit nuk ka mundur që të ofroi asnjë provë bindëse nga të cilat do të mund të vërtetohej teza e akuzës. Përkundrazi, në rastin konkret e kemi vetëm deklaratën e të dëmtuarit L. K. i cili deklaroi se ka dhënë shumën e të hollave, mirëpo, nuk din konkretisht se këtë shumë a i ka dhënë të akuzuarit apo jo pasi që sipas deklaratës së tij kanë qenë edhe persona tjetër dhe se nuk është i sigurt për një fakt të tillë. Poashtu, edhe nga deklarata e dëshmitarit Z. B. nuk ka mundur gjykata që të vërtetoi në mënyrë bindëse një gjë të tillë pasi që vet dëshmitari ka deklaruar se nuk është e vërtet që ai rastin ta ketë paraqitur në polici konkretisht sa i përket të akuzuarit, por deklarata e tij e dhënë në polici ka qenë gjatë fushatës elektorale ku është denoncuar në përgjithësi udhëheqësia komunale e jo konkretisht këtu i akuzuari A. K.

Në rastin konkret akuza nuk ka mundur të ofroj prova relevante nga të cilat do të mund të vërtetohej përgjegjësia penale e të akuzuarit për veprën penale të marrjes së ryshfetit nga neni 343 par.1. të KPK. Përkundrazi nga provat e ofruara dhe të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata nuk ka mundur që të vërtetoj se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës së lartëcekur penale, andaj në mungesë të provave e liroi të akuzuarin nga akuza.

Konform nenit 3 par.2 të KPP mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen, interpretohen në favor të të pandehurit. Në rastin konkret duke marr parasysh deklaratat kundërtënëse të dëmtuarit dhe të akuzuarit, e në mungesë të provave, interpretimi është bërë në favor të akuzuarit dhe gjykata ka marr aktgjykim si në dispozitiv.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv konform nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konformë nenit 454 par.1. të KPP.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti për Krime të Rënda
P.nr.30/15, më datë 21.12.2015.

Procesmbajtësja
Sheqere Braha

Kryetarja e trupit gjykues
Ajser Skenderi

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite nga dita e marrjes së të njejtit – **Gjykatës së Apelit në Prishtinë**, nëpërmjet të kësaj gjykate.